



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 11 dhe 12 "d" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe kërkesës së tri shoqatave të dalura nga lufta të datës 28.03.2012, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27.09.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim autorizohet Kryetari i Komunës që të angazhohet për shqyrtuar kërkesën e znj. Shehrije Ferati për t'i ndarë mjete financiare në vlerë prej 5.000 € (pesë mijë euro) për mbulimin e shpenzimeve për shërim.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa





REPUBLICA E KOSOVES - RE "CILESIA" KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRAN

01 Nr. / Br 272/12

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 27.09.2012

VUSHTRRI - VUÇITRAN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 "ç" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27.09.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Për ndryshim dhe plotësim të vendimit nr. 39/10, të datës 25.02.2010

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i kuvendit të komunës 01 Nr. 39/10 i datës 25.02.2010, ku anëtarin e deritashëm të komisionit, Murteza Dallkun, e zëvendëson Izet Miftari, në cilësinë e anëtarit në komisionin për intervistimin e kandidatëve për drejtorë të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Arsim.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa
Habib Mustafa



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, dhe nenin 4.2 të Udhëzimit Administrativ për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna Nr. 2008/10, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27.09.2012**, mori këtë:

V E N D I M
PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PËR ANËTARËSIM NË KOMITETET
KONSULTATIVE

Neni 1

Me këtë vendim shpallet konkursi për anëtarësim në këto Komitete Konsultative të KK-së:

- **Komiteti për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini (7 anëtarë);**
- **Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike (7 anëtarë);**
- **Komiteti për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit (7 anëtarë);**
- **Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale (7 anëtarë);**
- **Komiteti për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore (7 anëtarë).**

Neni 2

Kushtet e konkursit duhet të jenë në përputhshmëri me nenet 4.1, 4.3 dhe 4.4 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 2008/10.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryesuesi dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.



Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa
Habib Mustafa



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	270/12
Nr. i fq. / Br. st	-1-
Data: / Datum	27.09.2012
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtri

Në bazë të nenit 12.2 "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27.09.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e Rregullores mbi tatimin e pronës së paluajtshme

Neni 1

Aprovohet Rregullorja mbi tatimin në pronën e paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2013.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.1, 24.2 dhe 40.2 "b" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 40.2 "b" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27.09.2012**, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim aprovet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve prioritare për vitin 2013, konform Qarkores Buxhetore 2013/02 të MEF-it, dt. 26.07.2013, e që janë pjesë e këtij vendimi.

Neni 2

Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2013 është 12,601,906.00 €, prej të cilave për:

- Paga.....7,280,352.00 €.
- Mallra dhe shërbime.....1,153,560.00 €.
- Komunalitë..... 271,500.00 €.
- Subvencione.....155,000.00 €.
- Shpenzime kapitale..... 3,741,494.00 €.
- Githsejt:..... 12,601,906.00 €.**

Neni 3

Të hyrat vetanake të planifikuara.....1,550,000.00 €.

Neni 4

Mjetet financiare të cekura në nenin 2 dhe 3 të këtij vendimi do të sigurohen në pajtim me Qarkoren Buxhetore 2013/02 të MEF-it në bazë të kufijve të dhënë, Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe dispozitat tjera ligjore dhe aktet tjera që e rregullojnë këtë çështje.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe organet tjera kompetente.

Neni 6

Ky vendim hyn pas aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.



Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa